amf ALBANIA
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

ePeriodik
PUBLIKIM MUJOR NUMRI 89 | NËNTOR 2015

fq. 2 Publikimi i Progres Raportit 2015 të Komisionit Evropian për Shqipërinë

VËSHTRIM MBI TREGJET

» Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2015 fq. 2
» Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 shtator 2015 fq. 3

ZHVILLIME TË TJERA

» Tryezë e rrumbullakët me temë "Mbështetja e bashkëpunimit rajonal për mbikëqyrjen ndërkufitare dhe të grupeve në sigurime" fq. 5
» Mbledhja e përgjithshme vjetore e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve fq. 6
» Takimi i përbashkët midis AMF-së dhe autoriteteve mbikëqyrëse të Austrisë dhe Sllovenisë fq. 7
» Takimi i përbashkët midis AMF-së dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë fq. 8
» *Workshop* "Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare Financiare" fq. 8
» Trajnimi i 21-të ndërkombëtar mbi zhvillimin dhe mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë fq. 9

LAJMET NGA RAJONI

» Bullgari fq. 10
» Hungari fq. 10
» Kosovë fq. 10
» Mali i Zi fq. 11
» Turqi fq. 11

EDUKIMI I KONSUMATORIT

"E ardhmja e tregjeve të kapitalit në ekonominë dixhitale" fq. 12
Greg Medcraft, Kryetar i Komisionit Australian të Letrave me Vlerë dhe Investimeve të Australisë
(vijon nga numri i kaluar - pjesa e dytë)

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Për informacion të mëtejshëm ju lutemi na kontaktoni:
Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al

Publikimi i Progres Raportit 2015 të Komisionit Evropian për Shqipërinë

Komisioni Evropian ka publikuar Progres Raportin 2015 për Shqipërinë për përmbushjen e prioriteteve kyçe dhe detyrimeve të tjera që Shqipëria ka në procesin e integrimit evropian.

Duke vlerësuar ecurinë e vendit në shërbimet financiare, në kapitullin e 9-të, faqja 38, raporti vlerëson amendimet e bëra në Ligjin për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe punën e bërë nga Autoriteti për të rritur kapacitetet e tij institucionale. Për tregun e sigurimeve, Progres Raporti citon miratimin e rregulloreve nga AMF për parimet e përgjegjshmërisë, sistemet e kontrollit të rrezikut dhe kërkesave të likuiditetit.

Për tregun e letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve, raporti vlerëson rritjen e vazhdueshme të tyre edhe gjatë vitit 2014. Në veçanti citohet aprovimi i rregulloreve për administrimin e likuiditetit në fondet e investimeve dhe marrja e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 16.87% gjatë periudhës janar-tetor 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 11.11 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 6.56% duke arritur në 898,798 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 19.64% në krahasim me periudhën janar-tetor 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.66 miliardë lekë, apo 62.87% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 19.55% gjatë periudhës janar-tetor 2015, krahasuar kjo me periudhën janar-tetor 2014.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 6.79 miliardë lekë gjatë periudhës janar-tetor 2015, duke shënuar një rritje prej 21.02% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 61.21% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 13.87% të tregut të Jo-Jetës;
- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 13.15% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 8.66% krahasuar me periudhën janar-tetor të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit "Jetë debitori" e cila përbën 66.07% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-tetor 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 shtator 2015

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2015, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.09.2015 tregon një total asetesh neto prej 837.09 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 207.95 milionë lekë (33.05%) krahasuar me fundin e vitit 2014. E shprehur në euro, totali i aseteve neto është 6.01 milionë euro.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 30.09.2015 ishte 11,227 anëtarë duke shënuar rritje prej 32.22% krahasuar me fundin e vitit 2014.

Tregues të fondeve të pensioneve, 30 shtator 2015

Përshkrimi	*Vlera (mln. lekë)*		*Ndryshimi (Në %)*
	31.12.'14	*30.09.'15*	*31.12.'14-30.09.'15*
Asetet neto të FP	629.15	837.09	33.05

Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve, 30 shtator 2015

Fond Pensioni	*Numri i anëtarëve në FP*	*Asete Neto (mln. lekë)*
SIGAL	5.139	414.68
RAIFFEISEN	2.559	302.25
SiCRED PENSION	3.529	120.16
TOTAL	**11.227**	**837.09**

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve



Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve



ZHVILLIME TË TJERA

Tryezë e rrumbullakët me temë “Mbështetja e bashkëpunimit rajonal për mbikëqyrjen ndërkufitare dhe të grupeve në sigurime”

Gjatë zhvillimit të tryezës së rrumbullakët me temë “Mbështetja e bashkëpunimit rajonal për mbikëqyrjen ndërkufitare dhe të grupeve në sigurime”

Në datat 24-25 nëntor 2015 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi tryezën e rrumbullakët “Mbështetja e bashkëpunimit rajonal për mbikëqyrjen ndërkufitare dhe të grupeve në sigurime”. Aktiviteti u organizua në bashkëpunim me Trupën Vullnetare të Shërbimeve Financiare të USAID. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues të autoriteteve homologe, mbikëqyrëse të sektorit të sigurimeve nga vendet e Evropës Juglindore, si Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Republika Serbe e Bosnje-Hercegovinës dhe Sllovenia. Takimi u përshëndet nga Z. Peter Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA Austri, përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, njëherësh Drejtor i Komitetit të Buxhetit të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (*International Organisation of Insurance Supervisors, IAIS*). Në tryezën e rrumbullakët përshëndetën edhe Z. Sergei Simoniti, President i Këshillit të Ekspertëve dhe Drejtor i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Slloveni dhe Z. Klime Poposki, President i Këshillit të Ekspertëve në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoni.

Në fjalën e saj përshëndetëse, Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit midis rregullatorëve në rajon për tregun e sigurimeve. Znj. Shehi theksoi se autoritetet rregullatore kanë nevojë të kuptojnë më shumë tregjet e rajonit dhe të fillojnë të mendojnë më gjerë për harmonizimin e mekanizmave për mbikëqyrjen e grupeve, në përputhje me Parimet Bazë të Mbikëqyrjes dhe praktikat ndërkombëtare, si edhe të kenë një kuptim të përbashkët mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare.

Z. Peter Braumüller e konsideroi bashkëpunimin rajonal për mbikëqyrjen në sigurime si një çështje shumë të rëndësishme duke nënvizuar faktin se rreth 35% e primeve të shkruara bruto të kompanive austriake realizohen në vendet jashtë Austrisë. Ai vlerësoi sidomos punën e kolegjeve mbikëqyrëse, inspektimet e përbashkëta dhe mbledhjet teknike në forcimin e bashkëpunimit rajonal. Kuadri ligjor është i rëndësishëm, theksoi z. Braumüller, po aq sa edhe bashkëpunimi midis stafeve dhe rritja e njohurive, besimit dhe përkushtimit për bashkëpunimin rajonal.

Z. Sergei Simoniti, theksoi interesin që kanë pasur gjithnjë grupet sllovene të sigurimeve për tregun shqiptar. Edhe kjo pjesëmarrje në këtë aktivitet i shërben njohjes dhe vlerësimit më tej të tendencave të zhvillimit të tregut shqiptar të sigurimeve.

Duke përshëndetur tryezën e rrumbullakët, Z. Klime Poposki, evidentoi se nga 15 shoqëri që funksionojnë në tregun e sigurimeve në Maqedoni, 10 prej tyre kanë kapital të përbashkët, austriak, shqiptar dhe slloven dhe realizojnë së bashku rreth 80% të primeve të shkruara bruto. Ai vlerësoi shumë bashkëpunimin me AMF-në nëpërmjet inspektimeve të përbashkëta të realizuara nga të dy autoritet mbikëqyrëse të Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Ish komisionerja e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Bankave dhe Sigurimeve të shtetit të New Jersey, SHBA, me përvojë të gjatë në tregun e sigurimeve, Znj. Holly Bakke, prezantoi praktikat më të mira lidhur me mbikëqyrjen e grupeve dhe atë ndërkufitare, si edhe disa prej ndryshimeve më të fundit në Parimet Bazë të Sigurimeve (ICP). Gjatë aktivitetit, ekspertë të secilit nga vendet dhanë përvojat e vendit të tyre lidhur me zbatimin e ICP-ve për mbikëqyrjen e grupeve.

Në këtë tryezë u diskutuan mundësitë për koordinimin e strategjive rajonale lidhur me disa problematika në mbikëqyrjen në sigurime si licencimi, regjimi i aftësisë paguese, shkëmbimi i të dhënave, kujdesi për të dhënat konfidenciale, kërkesat për mbikëqyrjen e grupeve dhe atë ndërkufitare, si dhe roli i kolegjeve të mbikëqyrjes.

Në përfundim u ra dakord për zhvillimin e një kuadri të përbashkët pune për thellimin më tej të bashkëpunimit rajonal.

Mbledhja e përgjithshme vjetore e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilloi gjatë periudhës 9-13 nëntor 2015, në Marakesh, Marok, Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore, si dhe mbledhjet e komiteteve të saj. Pjesëmarrës në këto aktivitete ishin mbi 600 përfaqësues nga autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve, ekspertë dhe zyrtarë të lartë të organizatave ndërkombëtare.

E themeluar që në vitin 1994, IAIS përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e sigurimeve prej më shumë se 200 juridiksione, në 140 vende të botës, ku dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar me të drejta të plota dhe përfaqësohet në vazhdimësi, në nivel të lartë.

Ndër diskutimet kryesore të Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore - 2015 ishin:

- Praktikat e mbikëqyrjes, mjetet dhe metodat në mbikëqyrje;
- Standardet globale të kapitalit në sigurime;
- Roli i rregullatorëve në raportin midis zhvillimit të tregut dhe mbikëqyrjes së tij;
- Përgatitja e rregullatorëve për ndryshimet që lidhen me kërkesën konsumatore dhe risitë teknologjike;
- Rreziku kibernetik – sfidat për rregullatorët dhe siguruesit.

Gjatë mbledhjeve të komiteteve u finalizuan mjaft projekte dhe u miratuan dokumente teknike dhe strategjike duke përfshirë edhe rishikimin e Parimeve Bazë të Sigurimeve (IAIS Insurance Core Principles, ICPs). Këto ndryshime nisën pas përfundimit të procesit të vetëvlerësimit me ICP-të nga vendet anëtare të IAIS. Rishikimi i ICP-ve merr parasysh edhe zhvillimet e fundit në mbikëqyrjen e grupeve, qeverisjen e shoqërive dhe administrimin e rrezikut, si dhe parimet, standardet dhe udhëzimet e lëshuara nga organizma të tjerë hartues të standardeve ndërkombëtare.

Ndër ICP e rishikuara ishin:

- ICP 4 (Licencimi);
- ICP 5 (Përshtatshmëria e personave);
- ICP 7 (Qeverisja e Shoqërive);
- ICP 8 (Administrimi i Rrezikut dhe Kontrollet e Brendshme);
- ICP 23 (Mbikëqyrja e grupeve);
- ICP 25 (Bashkëpunimi dhe koordinimi midis rregullatorëve).

Ndër dokumentet teknike të rishikuara në këto takime ishin:

- Kërkesat për kapacitet shtesë për përballimin e humbjeve (për institucionet e rëndësishme për sistemin financiar global);
- Rregullimi dhe mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit të mbyllura (*ang. captives*);
- Rreziku i sjelljes së biznesit dhe administrimi i tij;
- Sjellja e biznesit në përfshirjen financiare dhe mikrosigurime;
- Rregullimi dhe mbikëqyrja e *mikrotakaful*, etj.

Takimi i përbashkët midis AMF-së dhe autoriteteve mbikëqyrëse të Austrisë dhe Sllovenisë

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së dhe përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse të Austrisë dhe Sllovenisë gjatë takimit

Në vijim të bashkëpunimit për çështjet e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në datat 24-25 nëntor 2015 në Tiranë, takime me përfaqësues të Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA) dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (ISO). Delegacioni nga FMA e Austrisë kryesohej nga Z. Peter Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, njëherësh Drejtor i Komitetit të Buxhetit të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS). Delegacioni nga ISO kryesohej nga Z. Sergej Simoniti, President i Këshillit të Ekspertëve njëkohësisht Drejtor i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë.

Takimi u përqendrua në zhvillimet kryesore në tregjet e sigurimeve të Austrisë, Sllovenisë dhe Shqipërisë gjatë vitit 2015, sidomos të shoqërive austriake të pranishme në Shqipëri dhe në rajon, masat mbikëqyrëse dhe përshkallëzimi i tyre, çështjet e ekuivalencës lidhur me trajtimin e të dhënave që përbëjnë sekret profesional në kuadër të EIOPA-s (Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve), mbështetja për qendrën e edukimit të ngritur pranë AMF-së, forcimi i bashkëpunimit, duke përfshirë edhe tregun e pensioneve private vullnetare, si dhe forcimi i bashkëpunimit rajonal për të përmirësuar praktikat e mbikëqyrjes dhe për t'u harmonizuar me standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes.

Ky takim u mbajt në kuadër të një përpjekjeje rajonale të iniciuar nga autoritetet mbikëqyrëse të Austrisë dhe Sllovenisë për të rritur vëmendjen dhe harmonizuar praktikat e autoriteteve rregullatore të rajonit të Ballkanit Perëndimor në çështjet e mbikëqyrjes dhe rregullimit të sjelljes në treg të operatorëve të tregut të sigurimeve. Nga diskutimet u theksua se trajtimi i çështjeve të sjelljes në treg është i rëndësishëm për kuadrin e mbikëqyrjes me bazë rreziku, në tregun e sigurimeve, por edhe në tregjet e tjera financiare. AMF shprehu gatishmërinë për të qenë pjesë e kësaj përpjekjeje.

Takimi i përbashkët midis AMF-së dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë

Në vijim të bashkëpunimit për çështjet e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në datën 25 nëntor 2015 në Tiranë, një takim me përfaqësues të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë. Delegacioni nga Maqedonia kryesohej nga Z. Klime Poposki, President i Këshillit të Ekspertëve.

Takimi u përqendrua në zhvillimet kryesore në tregjet e sigurimeve të Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe sidomos të shoqërive që e shtrijnë aktivitetin e tyre në të dy vendet. Ndër çështjet e diskutuara ishin masat mbikëqyrëse dhe përshkallëzimi i tyre, realizimi i inspektimeve të përbashkëta, forcimi i bashkëpunimit rajonal për të përmirësuar praktikat e mbikëqyrjes dhe për t'i harmonizuar ato me standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes.

Ky takim u mbajt në kuadër të një përpjekjeje rajonale të bashkëpunimit edhe me autoritetet mbikëqyrëse të Austrisë dhe të Sllovenisë për të rritur vëmendjen dhe harmonizuar praktikat e autoriteteve rregullatore të rajonit të Ballkanit Perëndimor në çështjet e mbikëqyrjes dhe rregullimit të sjelljes në treg të operatorëve të tregut të sigurimeve.

Workshop "Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare Financiare"

Instituti për Studimet Ndërkombëtare dhe të Zhvillimit i Zvicrës organizoi në datat 2-6 nëntor 2015 në Gjenevë, *workshopin* me temë "Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare Financiare". Qëllimi i këtij *workshopi* ishte qartësimi i detajuar i mënyrave të bashkëveprimit me institucionet financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Pjesëmarrës në këtë takim ishin ekzekutivë të lartë nga autoritetet rregullatore të tregjeve financiare nga vende të ndryshme të botës, të cilët në vendet e tyre janë të përfshirë në dialog bashkëpunues me institucionet financiare ndërkombëtare.

Gjatë *workshopit* u prezantuan çështje kryesore makroekonomike dhe u analizuan treguesit kryesore ekonomikë e financiarë të vendeve pjesëmarrëse. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u prezantua nga Nëndrejtorja Ekzekutive e AMF-së, e cila prezantoi gjetjet dhe rekomandimet e dy programeve vlerësuese të sektorit financiar (*Financial Sector Assessment Program, FSAP*) të kryera në Shqipëri në vitin 2006 dhe 2013. Në prezantim u pasqyruan se si rekomandimet e FSAP 2013 në Shqipëri kanë mbështetur në hartimin dhe aprovimin e kuadrit ligjor rregullues. Rekomandimet e FSAP 2013, si bashkëpunim i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, në Shqipëri u fokusuan në fuqizimin e kapaciteteve të AMF-së për të tre tregjet nën mbikëqyrje:

- Nevojën për adoptimin e mbikëqyrjes më fokus risku sidomos në tregun e sigurimeve;

» Promovimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të tregut të pensioneve private vullnetare; si dhe
» Fuqizimin e kërkesës për menaxhimin e likuiditeteve, vlerësimin e aseteve dhe mbrojtjen e investitorëve të fondeve të investimeve.

Gjatë *workshopit*, pjesëmarrësit simuluan një ushtrim praktik të negocimit me institucionet ndërkombëtare, duke u ndarë në grupe pune dhe duke u vendosur në role të ndryshme gjatë proceseve të negocimit. Në përfundim të *workshopit*, pjesëmarrësit diskutuan dhe ndanë përvojat e vendeve të tyre gjatë negociatave me institucionet ndërkombëtare.

Trajnimi i 21-të ndërkombëtar mbi zhvillimin dhe mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë

Komisioni i Këmbimit të Letrave me Vlerë (*Securities Exchange Commission*) SEC, zhvilloi gjatë periudhës 2-6 nëntor, në Washington, SHBA, trajnimin e 21-të ndërkombëtar mbi zhvillimin dhe mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë. Në këtë trajnim merrnin pjesë përfaqësues nga 54 autoritete të ndryshme rregullatore. Temat e trajtura nga lektorët u zhvilluan si në aspektin teorik, duke shpjeguar konceptet dhe arsyetimet logjike, si dhe duke i lidhur ato me trajtimin e rasteve specifike.

Temat kryesore që u trajtuan lidheshin me:

» Hetimet dhe ndjekjet penale mbi tregtinë e brendshme – raste studimore. Pikat kryesore të kësaj teme kishin të bënin me ligjin në SHBA mbi tregtinë e brendshme, njohjen e ligjit mbi letrat me vlerë, teorinë e shpërdorimit të informacionit, si dhe studimi i rastit të Raj Rajaratnam, themeluesit të fondit Galleon Group LLP, i cili u arrestua në vitin 2009 nga FBI, si rasti më i madh në historinë e mashtrimit të tregtisë së brendshme;
» Prezantimi i rasteve të letrave me vlerë në gjykatë. Kjo temë prezantoi procedurën administrave dhe gjyqësore të trajtimit të rasteve të mashtrimeve të letrave me vlerë. Gjithashtu, u prezantuan disa raste konkrete të trajtuara nga gjykata, midis tyre rasti i Fabrice Tourre, i cili mashtroi në Bursën e Wall Street në shumën rreth 1 miliard dollarë;
» Hetimet e kryera mbi mashtrimet financiare që përfshijnë kompanitë publike, dhe mënyra e organizimit të Autoritetit Rregullator të Industrisë Financiare. Në këtë temë u vu theksi tek efekti që ka mashtrimi financiar në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe cilat janë skemat e zakonshme të mashtrimit financiar;
» Instrumentet Financiare: Këmbime & Derivatet. Në këtë temë u trajtua kuptimi i "Këmbimit" si një marrëveshje midis dy palëve për të shkëmbyer rreziqet, çfarë lloj rreziqesh mund të shkëmbehen dhe derivatet e tyre;
» Mjetet dhe teknikat për të zbuluar dhe hetuar mashtrimet dhe abuzimet e fondeve. Kjo temë u trajtua në formën e një seminari bashkëveprues ku çdo vend ndan me pjesëmarrësit mjetet dhe teknikat ligjore të tyre për zbulimin dhe hetimin e mashtrimeve.

Ky seminar trajnues, krahas dhënies së aspekteve teorike dhe informacioneve me raste specifike, i shërbeu edhe krijimit të një rrjeti bashkëpunimi midis pjesëmarrësve të tij, për të shkëmbyer informacione dhe praktikat më të mira të secilit autoritet rregullator.

LAJMET NGA RAJONI

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave statistikore të publikuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare në Bullgari (FSA), gjatë nëntëmujorit të vitit 2015, tregu bullgar i sigurimeve u rrit me 9.7% duke arritur shifrën 722.5 milionë euro. Tregu i sigurimit të Jetës arriti një total prej 152.5 milionë euro ose 22% më shumë sesa vitin e kaluar. Kjo lidhej më shumë me rritjet në segmentet tradicionale (me 17%) dhe produktet e lidhura me skema investimi me rritje prej 113%. Ndërkohë që sektori i sigurimit të Jo-Jetës gjeneroi rreth 80% të tregut total të sigurimeve, me vlerë rreth 570 milionë euro ose 6.8% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014.

Në sigurimin e Jo-Jetës, produktet MTPL përfaqësuan 30% të totalit të sigurimeve. Më pas vinte sigurimi Kasko i cili zinte 25% dhe sigurimet e pronës, që zinte 13.4% të tregut.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga Banka Kombëtare, në nëntë muajt e parë të vitit 2015, primet e shkruara bruto të siguruesve hungarezë u rritën me 2.6% në krahasim me vitin e kaluar duke arritur në 647 miliardë HUF(monedha lokale) ose rreth 2 miliardë euro. Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës pësuan një rënie prej 1.5% duke arritur në 333 miliardë HUF, ndërkohë që të ardhurat nga primet për kontratat e përgjithshme të sigurimit u rritën me 7.3% duke arritur në vlerën 314 miliardë HUF.

Në tërësi, vlera e dëmeve të paguara arriti një total prej 398 miliardë HUF, ose rreth 1.3 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 5.3% në krahasim me vitin e kaluar. Nga këto dëme 265 miliardë HUF ishin dëme të paguara për sigurimin e Jetës dhe 132 miliardë HUF ishin dëme të paguara për sigurimin Jo-Jetës.

KOSOVË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës, në tremujorin e tretë të vitit 2015, siguruesit kosovarë, në sigurimin e Jo-Jetës, raportuan një rënie të lehtë në volumin e primeve të shkruara bruto, prej 0.27%, në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 61.03 milionë euro. Dëmet e paguara nga siguruesit vendas për këtë periudhë u rritën në mënyrë të ndjeshme me 17.54% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 23.07 milionë euro.

Në tërësi, primet MTPL përfaqësuan rreth 70% të totalit të primeve të shkruara bruto, nga të cilat 55% e përbënin policat e përgjegjësisë ndaj palëve të treta dhe policat kufitare me rreth 15%. Sigurimet e tjera vullnetare përfaqësuan rreth 30% të të gjithë tregut.

Në periudhën e analizuar, numri total i policave të shitura nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës u llogarit në 784.86 mijë, krahasuar me 765.71 mijë polica gjatë muajve janar-shtator 2014.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara në faqen zyrtare *online* të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Malin e Zi, shoqëritë e sigurimit, gjatë muajve janar-shtator 2015, raportuan një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 57.3 milionë euro. Kjo shpreh një rritje prej 6.3% më shumë sesa vitin e kaluar. Primet e sigurimit të Jo-Jetës arritën një total prej 48.5 milionë euro, duke u rritur me 6.9% krahasuar me vitin e kaluar. Sigurimet e Jetës realizuan një volum të primeve prej 8.8 milionë euro, ose 4% më shumë sesa vitin e kaluar.

Në periudhën e analizuar, vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit u ul me 2% duke arritur në 21.2 milionë euro, nga të cilat më shumë se 18 milionë euro i takonin 8 klasave të Jo-Jetës.

Krahasuar me të njëjtë periudhë të vitit 2014, gjatë muajve janar-shtator 2015, siguruesit e Malit të Zi lëshuan rreth 51,000 polica më shumë duke arritur një total prej 373,236 policash sigurimi. Kjo për shkak të rritjeve të raportuara më shumë në sigurimin MTPL, shëndet në udhëtim dhe aksidente.

Në të njëjtën kohë, njëmbëdhjetë siguruesit vendas shlyen në periudhën e analizuar rreth 27,062 dëme, kundrejt 24,615 në të njëjtën periudhë të vitit 2014. Nga dëmet e paguara rreth 8,800 lidheshin me kontratat e sigurimit për aksidente, 8,100 ishin për TPL për mjetet motorike, 2,800 dëme u paguan në kontratat e shëndetit, 2,300 dëme u paguan në sigurimin Kasko, 2,000 dëme u paguan në sigurimin e Jetës dhe 1,800 dëme u paguan në sigurimin e pronës.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas publikimeve në faqen zyrtare online të Shoqatës së Sigurimeve të Turqisë, sektori turk i sigurimeve, në fund të muajit shtator të vitit 2015, arriti një total prej 22 miliardë TRY (monedha lokale) ose rreth 6.5 miliardë euro. Kjo përfaqëson një rritje nominale prej 16.1% në krahasim me vitin e kaluar.

Tetë nënklasa kryesore, që gjenerojnë së bashku më shumë se 95% të tregut të sigurimeve në total, raportuan rritje të larta. Kështu sigurimi i Jetës u rrit me 12.6%, sigurimi nga aksidentet u rrit me 12.7%, sigurimi nga sëmundja dhe shëndeti u rrit me 17.3%, sigurimi Kasko për mjetet motorike u rrit me 8.6%, sigurimi nga zjarri dhe rreziqe të tjera u rrit me 13%, sigurimi i dëmeve të tjera në pronë u rrit me 24%, përgjegjësia për mjetet motorike u rrit 20.2%.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit vendas u rrit me 15.3% në krahasim me vitin e kaluar duke arritur në 11.2 miliardë TRY ose rreth 3.3 miliardë euro, nga të cilat rreth 50% lidheshin me sigurimin e mjeteve motorike dhe më shumë se 15% me linjat e sigurimit të pronës.

EDUKIMI I KONSUMATORIT

“E ardhmja e tregjeve të kapitalit në ekonominë dixhitale”

Fjala e mbajtur nga Greg Medcraft, Kryetar i Komisionit të Letrave me Vlerë dhe Investimeve të Australisë (Australian Securities and Investments Commission) me studentë dhe pedagogë në Universitetin Carnegie Mellon në Adelaide, Australia, 16 shtator 2015. Z. Greg Medcraft është gjithashtu edhe Kryetar i Bordit të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) e cila mbledh së bashku rregullatorë të tregut nga më shumë se 120 juridiksione, të cilat përfaqësojnë mbi 90% të vlerës së tregjeve të kapitalit në botë.

Në fjalën e tij ai flet specifikisht për tre çështje: (i) Disa nga ndryshimet që sjellin teknologjitë dixhitale në modelet ekzistuese të biznesit; (ii) Mundësinë që këto zhvillime kanë për tregjet kapitale ashtu siç i njohim ato, duke ju referuar në mënyrë të veçantë emergjencës së teknologjisë së bazës së të dhënave; (iii) Mënyrën se si mund të përgjigjen rregullatorët.

(Pjesa II. Marrë me shkurtime)

(vijon nga numri i kaluar)

Potenciali që kanë këto zhvillime për tregjet e kapitalit

Për të ndihmuar që të kuptoni se çfarë do të thotë kjo sfidë për ne, dua të flas në mënyrë më të detajuar për teknologjinë *blockchain* (zinxhir i bazës së të dhënave). Kjo teknologji – nëse do të përparojë ashtu siç e mendoj unë – ka potencialin që të ndryshojë në mënyrë themelore tregjet tona dhe sistemin tonë financiar.

Çfarë është teknologjia blockchain?

Ndoshta ju keni dëgjuar për *bitcoin* – monedhën dixhitale. *Blockchain* është algoritmi ku bazohet bitcoin, i cili lejon që ai të tregtohet pa një libër të centralizuar llogarish. Në terma bazë, është një libër elektronik llogarish për ngjarjet dixhitale – një libër që “shpërndahet” ose ndahet ndërmjet shumë palëve të ndryshme. Ai përmban një listë gjithnjë në rritje të regjistrimeve të të dhënave.

Blockchain ka tre karakteristika kryesore:

Në rradhë të parë, është një mjet për transferimin e vlerave dhe mbajtjen e rregjistrimeve – çdo transaksion ose regjistrim evidentohet me një set të dhënash unike ose “bllok” që i bashkëlidhet një “*blockchain*” gjithnjë në rritje.
Së dyti, ai nuk përfshin një autoritet qendror ose palë të tretë që e mbikëqyr apo vendos se çfarë përfshihet në të. Kompjuterët që ruajnë “*blockchain*” janë të decentralizuar dhe nuk kontrollohen apo zotërohen nga një ent i vetëm.
Së treti, çdo bllok në librin e llogarive është i lidhur me atë paraprirës në një algoritëm zinxhir dixhital. Në këtë mënyrë, regjistrimi i çdo transaksioni ekziston në kompjuterat e çdokujt që ka ndërvepruar me të, dhe përditësohet pas çdo regjistrimi. Kopjimi i vazhduar dhe natyra e decentralizuar e bën atë të sigurt.

Si mund të transformojë blockchain tregjet e kapitalit?

Unë shikoj katër arsye.

Së pari, efikasitet dhe shpejtësi. Aktualisht, kur investitorët blejnë dhe shesin detyrime (*debt*) apo letra me vlerë (*equity securities*) ose bëjnë transaksione me derivatet, ata përgjithësisht mbështeten në zgjidhjen dhe regjistrimin e sistemeve të cilave u duhet disa ditë. Ndonjëherë mund të zgjasë edhe më shumë, aty ku tregtia përfshin palët ndërkufitare. Blockchain ka potencialin për të automatizuar të gjithë këtë proces.

Së dyti, reduktimi i ndërmjetësimit. *Blockchain* automatizon besim; ai eliminon nevojën për ndërmjetës "të besuar", si palë e tretë. Në tregun tradicional, blerësit dhe shitësit nuk mund t'i besojnë automatikisht njëri-tjetrit, kështu që ata përdorin ndërmjetës për të pasur besimin e duhur. Me *blockchain*, blloku i llogarive i decentralizuar e ofron këtë besim. Investitorët mund të përballen me njëri-tjetrin dhe me emetuesit në tregjet private në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Së treti, kosto të reduktuara transaksionesh. Duke eliminuar nevojën për të përdorur sisteme pagesash, regjistrimi dhe mënyra të tjera të ndërmjetme, ekziston një potencial i rëndësishëm për të reduktuar kostot e transaksionit për investitorët dhe emetuesit.

Së katërti, akses më të mirë në treg. Për shkak të natyrës globale të blockchain, tregjet globale kanë potencial për t'u bërë më lehtësisht të aksesueshme për investitorët dhe emetuesit, duke e bërë më të lehtë për investitorët dhe emetuesit që të investojnë dhe emetojnë detyrime dhe letra me vlerë.

Natyrisht, shfrytëzimi i këtij potenciali do të varet nga integriteti, kapaciteti dhe stabiliteti i teknologjisë dhe proceseve të *blockchain*. Ai do të varet gjithashtu nga gatishmëria e industrisë për të investuar dhe përdorur mënyra të reja për të shlyer dhe regjistruar transaksionet. Megjithatë, potenciali është shumë i madh. Industria po e vëren këtë potencial dhe po shikon mënyrat sesi ajo dhe tregjet mund të përfitojnë.

Zhvillimet e Blockchain

Më lejoni të përmend katër hapësira ku eksplorohen përfitimet e *blockchain*:

E para, në tregtinë e aksioneve, kredive dhe derivateve. Një seri iniciativash po shikojnë mundësinë e shfrytëzimit të *blockchain* për të realizuar tregtimin e derivateve dhe letrave me vlerë.

E dyta, në transaksionet e kapitaleve private. Bursa e Shteteve të Bashkuara, NASDAQ, po eksperimenton duke përdorur teknologjinë e *blockchain* si një mënyrë regjistrimi të transaksioneve të kapitaleve private. Duke vepruar kështu, shpresohet të sigurohet integritet i plotë, kapacitete auditimi, qeverisje dhe transferim të kapaciteteve të pronësisë.

E treta, në bonot qeveritare. Një kompani amerikane po zhvillon një mënyrë për të përdorur "*blockchain*" për të regjistruar dhe shlyer tregtimin e bonove qeveritare afatshkurtra në një libër llogarish.

E katërta, në transferimin e parave. Një firmë në Meksikë ka zhvilluar një aplikacion që i lejon emigrantët të dërgojnë para nëpërmjet *blockchain* drejt Meksikës dhe pastaj ata mund të tërheqin para nga ATM-të.

(Vijon në numrin e ardhshëm)